



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 150, datë 28.09.2023

PËR MIRATIMIN E KËRKESËS PËR TRANSFERIMIN PËRFUNDIMTAR DHE PËRDITËSIMIN E TË DHËNAVE, TË PRONËS ME NR. 1810, TË LISTËS SË TRANSFERIMIT, ME EMËRTIMIN “BEFOTROFI I VJETËR”

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja “b” dhe nënpika 1.2, shkronjat “a” dhe “c”, nenit 23, pika 14, nenit 28, nenit 54, shkronja “k”, nenit 55, pika 2 dhe 6, të Ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, Ligjit nr. 8743, datë 22.02.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, nenit 3, të Ligjit nr. 8744, datë 22.02.2001, “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, nenit 36, 37 dhe 38, si dhe nenit 39, pika “1.b”, të Ligjit nr. 20/2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 28, datë 27.01.2023, “Për përcaktimin e procedurave të hollësishme të përditësimit të listave të pronave shtetërore dhe rregullave për bashkëpunimin ndërmjet institucioneve”, Vendimit nr. 500, datë 14.08.2001, të Këshillit të Ministrave, “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, udhëzimit nr. 15, datë 30.06.2003, të Ministrit të Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit, “Për mënyrën e paraqitjes nga njësitë e qeverisjes vendore të kërkesave për transferimin në pronësi të tyre të pronave të paluajtshme publike”, VKM-së nr. 669, datë 07.8.2013, “Për miratimin e rregullave për përcaktimin, krijimin dhe realizimin e kornizës referuese gjeodezike shqiptare (KRGJSH) si metadatë”, i ndryshuar, VKM-së nr. 782, datë 07.10.2020, “Për miratimin e modeleve të akteve kadastrale dhe të dhënave në përmbajtjen e hartës kadastrale”, si dhe në vijim të Urdhërit nr. 238, datë 13.7.2023, për përditësimin e tre pronave në pronësi të Bashkisë Durrës, sipas relacionit të përgatitur nga Drejtoria Ligjore, me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

KËSHILLI BASHKIAK
V E N D O S I :

1. Miratimin e kërkesës për transferimin përfundimtar të pronës me nr. 1810, të listës së transferimit, me emërtimin “Befotrofi i Vjetër”, transferuar në pronësi të Bashkisë Durrës me VKM nr. 536, datë 01.5.2008.
2. Miratimin e përditësimit të pronës me emërtimin “Befotrofi i Vjetër”, që mban nr. 1810 të listës së transferimit, për shkak se gjendja reale (faktike) e pronës, ku përfshihen sipërfaqja, pozicioni, konfigurimi dhe karakteristikat e tjera fizike, nuk përputhen me dokumentacionin e inventarizimit, miratuar me VKM nr. 536, datë 01.05.2008.
3. Miratimin e planrilevimit të pronës me emërtimin “Befotrofi i Vjetër”, i hartuar sipas kërkesave të VKM-së nr.782, datë 07.10.2020, “Për miratimin e modeleve të akteve kadastrale dhe të dhënave në përmbajtje të hartës kadastrale”, bashkëlidhur këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
4. Miratimin e formularit të përditësimit të pronës me emërtimin “Befotrofi i Vjetër”, i plotësuar sipas kërkesave të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 28, datë 27.1.2023, “Për përcaktimin e procedurave të hollësishme të përditësimit të listave të pronave shtetërore dhe rregullave për bashkëpunimin ndërmjet institucioneve”, bashkëlidhur këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
5. Ngarkohet Drejtoria Ligjore (Sektori i Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve) për ndjekjen e procedurave të mëtejshme ligjore nëpërmjet Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, kjo në zbatim të Ligjit nr. 111/2018, “Për kadastrën”, Ligjit nr. 20/2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 28, datë 27.01.2023, “Për përcaktimin e procedurave të hollësishme të përditësimit të listave të pronave shtetërore dhe rregullave për bashkëpunimin ndërmjet institucioneve”, Ligjit nr. 8744, datë 22.02.2001, “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, i ndryshuar dhe VKM-së nr. 500, datë 14.8.2001, “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK

Ani Dyrmishi

U shpall sot me datë 29.09.2023

Lidhja 1

Bashkia Durrës, Njësia Durrës

Numri rendor i pronës në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
1810	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik.	Në pronësi



PLAN RILEVIMI PER PUNIME KADASTRALE


PRONARI _SHTET_

DATE 01/09/2023

QELLIMI_PER PERDITESIM

VENDNDODHJA: BASHKIA DURRES DVASHK/ZVASHK DURRES ZONA KADASTRALE 8513 NUMRI PASURISE 3/173 INDEX HARTE DR-III-1
 TE DHENAT E PASURISE: LLOJI PASURISE: SIP.PASURISE=451 m2 SIPERFAQE GJURMES NDERTIMIT= 451 m2 NUMRI KATI VI NUMRI PEFIEVI

KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE



SH 1:2500

Nr.	ORIENTIMI	PERDORIMI	TIPI KUFIRIT	KUFITARI	ID/NIPT	SHENIME TE REALIZUESIT
1	V			3/300		
2	J			3/258, 3/181		
3	L			3/177		
4	P			3/320, 3/321		

REALIZOI PER BASHKINE DURRES

Punoi, grupi i punoi sipas urdhrimit Nr.335, Datë 13.07.2023

ALEKS PRENGA
 ANILA MUHJA
 ARDITA MOLLA
 ERVIS BASHITI
 FATJON ZEQIRI

PERQJEGJES SEKTORI PRONARE: PRANVERA GAGANI
 NENSHKRIMI

DREJTORIA LIGJORE : ELIJS JANI
 NENSHKRIMI

DERASHI:
 NENSHKRIMI

KRYETAR: EMIRIANA SAKO
 NENSHKRIMI

TEKNOLOGJIA E MATJEVE: _____
 Kode per teknologjine e matjeve: T-Terren; Z-Zyre; O-Ortofoto; G-GPS; S-Station Total; D-Matje Distancash;
 PERCAKTIMI KUFIRIT: _KP;HK.
 Kode per percaktimin e kufirit:P-Përfaqësues i Pronarve; K-Kufitarei të Gjithë; KP-Kufitarët Pjesërisht;
 PB-Përfaqësues Bashkie, HK-Harta Kadastrale;
 SHENIME TE VECANTA: Sipas VKM-së Nr. 536, dt. 01.05.2008, formulant te inventarizimit bashkëlidhur VKM-së ka kaluar 1 pjese ne pronesi te Bashkise Durrës te pasurise 3/173.Bashkia Durres kerkon qe te perditesoje te gjithe pasurine 3/173 ndertim + truall. Nga matjet faktike rezulton 451 m2 truall , 451 m2 ndertim.
 PRONARI/BASHKEPRONARET-DEKLARIM MBI MARREDHENIET ME KUFITARET

Kode per teknologjine e matjeve dhe percaktimi kufirit: T-Terren; Z-Zyre; O-Ortofoto; G-GPS; S-Station Total; D-Matje Distancash, P-Përfaqësues i Pronarve; K-Kufitarei të Gjithë; KP-Kufitarët Pjesërisht; PB-Përfaqësues Bashkie, HK-Harta Kadastrale

1. FORMULARI I PËRDITËSIMIT TË PRONËS

Identifikimi pronëtar: Aleks Prenga, (specialist) / Anila Mulla, (specialiste) / Ardita Molla (specialiste),
 Ervis Bahiti (specialist) / Fajon Zoti (specialist)

Per ASHK Durres: Ramonel Tafta (specialist) / *[Signature]*


Supervizori: Pranvera Gagani (emri, mbiemri, pozicioni zyrtar) / *[Signature]*
 Elio Jani (emri, mbiemri, pozicioni zyrtar) / *[Signature]*
 Drejtoria Llogjore (emri, mbiemri, pozicioni zyrtar) / *[Signature]*
 KRYETAR (emri, mbiemri, pozicioni zyrtar, tel., firma, qelq)

Instytucioni Qendror Shtetëror / Bashkia: Durres

[Stamp: REPUBLIKA E SHQIPËRISE - DURRES]

Nr.	Zona Kadastr. & Indeksi i Hartes	Lloji i Pasurisë	Emërtesa e pasurisë	Nga Sip.		Funksioni për të cilin përdoret pronat/pasuria	Institucioni me përgjegjësi administrative/pronësi	Institucioni përdorues i pasurisë	Inventarizuar me	Shënime të veçanta
				Truall (m2)	Ndërtesë (m2)					
1810	8513 H.J - 45	Truall + Nderitim	Qendër Multifunksionale Shëndetsore Rr.K.Nushi, Lagja.Nr 6 Bashkia Durres	451 m2	451 m2	Shendet Paresor	Bashkia Durres	Bashkia Durres	VKM VKM nr.536 DL01.05.2008	Befotraf i vjeter
OTAL										

Shënim: Sipërfaqja totale do të plotësohet vetëm për pronat me shumë komponentë (që përbëhen nga disa pasuri).



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DURRËS

Nr. 629/Prot.
8

Durrës, më 05.10.2023

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

**KËSHILLIT BASHKIAK
DURRËS**

**KRYETARIT TË BASHKISË
DURRËS**

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.150 datë 28.09.2023 “Për miratimin e kërkesës për transferimin përfundimtar dhe përditësimin e të dhënave, të pronës me nr.1810, të listës së transferimit, me emërtimin “Befotrofi i vjetër”.

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI

EMILJAN JANI

